

	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	01.06.2026
	<b>KOMUNA E SUHAREKËS</b> OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
<b>MARRË NË DORËZIM PRILJENO-RECEIVED</b>		
Njësia org. Org. Jedinica <b>SUHAREKË</b>	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix
Vlera Vrednost Value	01	361
24996	2	

Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

Datë: 01.06.2026

Në bazë të Vendimit Nr. 01-Nr-016-29991, datë 30.05.2024 të Kuvendit Komunal dhe në bazë të Procesverbalit Nr. 02/2024 të Komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të datës 26.03.2026, komisioni përkatës shpall:

### KONKURIM TË HAPUR

Nr. 02/2024

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës komunale:

1.1 Banesa e cila gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, objekti **O-72116046-56-2-13-0**, hyrja H-2, kati përdhësë (NK), sipas sistemit të unifikuar të adresave, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S = 58.97 \text{ m}^2$ , pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Deklarata e bashkësisë familjare, e lëshuar nga sektori i gjendjes civile.

Kriteret e vlerësimit:

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara – 10%
- Përparësi kanë familjet e dëshmorëve – 60%
- Dëshmi që ofertuesi është anëtar i familjes së dëshmorit – 10%
- Çmimi fillestar për  $\text{m}^2$ : 1 € / muaj – 20%

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve nënkupton diskualifikim.
- Aplikuesi ka të drejtë të tërhiqet nga aplikimi jo më vonë se 3 (tri) ditë nga hapja e ofertave.
- Familjet të cilat kanë përfituar parcelë, banesë, shtëpi apo përfitime të ngjashme për sigurim të banimit nga Komuna nuk kanë të drejtë konkurrimi.
- Aplikuesi mund të jetë përfitues vetëm i një njësie banesore.
- Aplikuesi duhet të specifikojë për cilën njësi banesore aplikon, duke përfshirë numrin, katin dhe sipërfaqen në  $\text{m}^2$ .

Sqarim:

**Banesa e lartcekura kanë nevojë për renovim.**



Afati për tërheqjen e formularëve të ofertave është deri më datë 16.06.2026, në Zyrën e Gjendjes Civile nr. 1, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më datë 16.06.2026, deri në ora 13:30, në Zyrën Pritëse nr. 1, Komuna Suharekë.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf dhe të protokoluara në Zyrën Pritëse nr. 1.

Hapja e ofertave bëhet më 16.06.2026 në ora 14:30, në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i emëruar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, ndërsa përfituesin e vendos Kuvendi Komunal konform Ligjit Nr. 06/L-092.

Për informata shtesë:

Tel: 049/563-420

E-mail: [armend.m.krasniqi@rks-gov.net](mailto:armend.m.krasniqi@rks-gov.net)

Kryesuesi i Komisionit

Armend Krasniqi

